

AKT NORMATIV
Nr.22, datë 27.5.2020

PËR SHFUQIZIMIN E AKTIT NORMATIV NR.13, DATË 2.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË FUSHËN E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR, NDËRMJETËSIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PROCEDURAVE TË FALIMENTIMIT GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, MIRATUAR ME LIGJIN NR.34/2020

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Akti normativ nr.13, datë 2.4.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbarrimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me ligjin nr.34/2020, shfuqizohet.

Neni 2

Dispozitë tranzitore

Afatet që kishin filluar të llogariten, por u pezulluan sipas pikës 1, të nenit 3, të aktit normativ nr.13, datë 2.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbarrimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, për pjesën e paplotësuar të afatit. Afatet që duhet të fillonin gjatë periudhës së pezullimit, fillojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama